

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetar kolegji dhe gjyqtarëve: Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit F.Th., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1379/2017 të datës 18.08.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1216/2017 të datës 26.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit F.Th., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1379/17 të datës 18.08.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1216/2017 të datës 26.01.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.496/17 të dt.09.10.2017, të dënuarit E.K., F1.Th1. dhe F.Th., janë shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së dhe janë dënuar me dënime burgimi në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti, në të cilat dënime u është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 16.05.2017 deri me datë 14.07.2017 dhe dënime me gjobë në shuma prej nga 300 (treqind) €. Në emër të paushallit gjyqësor janë obliguar të paguajnë shumën prej 30 (tridhjetë) €, kurse i dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA.1nr.1216/2017 e datës 26.01.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve E.Th., F1.Th1. dhe F.Th., kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F.Th., av. V. O. nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe të marr vendim të ri duke zbut dënimin e shqiptuar apo çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka marrë për bazë dhe nuk ka çmuar të gjitha provat e administruara dhe po të zbatoheshin në mënyrë të drejtë dispozitat e procedurës penale, i dënuari do të shpallej fajtor për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe jo veprës penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin shqiptimit të dënimit, nuk ka pasur parasysh rolin e të dënuarit gjatë kryerjes së veprës penale, bashkëpunimin me organet nga momenti i arrestimit, sjelljen e tij korrekte gjatë procedurës, gatishmërinë për kompensimin e të dëmtuarit dhe faktin se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin. Posaçërisht premtimi i të dënuarit se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre dhe se është mbajtës i familjes dhe punëtor fizik do të kishin ndikim në lartësinë e dënimit.

Sipas pretendimeve të paraqitura në kërkesë edhe gjykata e shkallës së dytë, nuk i ka vlerësuar drejt faktet e çështjes dhe pretendimet ankimore, se i dënuari ka pasur rolin e rojës gjatë kryerjes së veprës penale nga të dënuarit e tjerë, përkatësisht ka pasur rolin e përcjelljes dhe kujdesin për vendin e ngjarjes.

Më tutje në kërkesë pretendohet se të dënuarit, gjykata e shkallës së dytë i ka vërtetuar dënim të lartë dhe jo proporcional dhe nuk ka marrë për bazë faktet e çështjes dhe nuk i ka arsyetuar pretendimet ankimore për çka edhe ky vendim përmban shkelje të njëjta ligjore.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.61/2018 e datës 03.04.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet.

Është e rëndësishme të theksohet se i dënuari, ka bërë pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 248 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është aprovuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar, kur nuk ka administruar prova pasi që i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë duke konstatuar se pranimi i fajësisë ishte pranim vullnetar, i dënuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe mbështetet në faktet e çështjes. Bazuar në procesverbalin e shqyrtimit fillestar rezulton se prezent ka qenë edhe mbrojtësi i të dënuarit, av. O.Z., i cili nuk ka bërë vërejtje në pranimin e fajësisë nga i dënuari e as për kualifikimin juridik të veprës penale apo aspekte tjera të pranimi të fajësisë nga ana e të dënuarit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimet drejtë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë formuar elementet qenësore të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPPK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj po ashtu, ka arsyetuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit dhe atë moshën relativisht të re e të dënuarit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, sjelljen korrekte si dhe gjendjen e dobët ekonomike dhe posaçërisht ka vlerësuar pranimin e fajësisë dhe për këtë arsye edhe i ka shqiptuar dënim nën minimumin e përcaktuar ligjor, duke zbatuar drejtë dispozitat e zbutjes së dënimit.

Gjykata e shkallës së dytë, ka arsyetuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të të dënuarit, se me rastin e pranimit të fajësisë nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, konform dispozitës së nenit 383 par.2 të KPPK-së.

Pretendimi përkitazi me rolin e të dënuarit në kryerjen e veprës penale, po ashtu gjykata e shkallës së dytë ka paraqitur arsyetim të mjaftueshëm dhe me të drejtë është konstatuar se veprimet e të dënuarit janë veprime të bashkëkryerjes në raport me të dënuarit e tjerë dhe me këtë rast edhe i dënuari ka dhënë kontribut në përfundimin me sukses të veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë veprë penale gjegjësisht dënimin me burgim brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, kështu që pretendimi i të dënuarit të paraqitura në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.84/2018, më datë 30.04.2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka